

Dionis Bubani

BIBLIOTEKA

E


85H - 7
B 88

SHTELTIT



PA DOREZA

POEZI SATIRIKE



8JH-7
B 88

DIONIS BUBANI

PA DOREZA...

poezi satirike



49/35

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHERI»

I. Na falni për këto mungesa...

PËRGJIGJE E LEHTE

Ju ha meraku shpesh
të merrni vesh
gjithmonë
se ç'na mungon...

... Një tok mungesash, që i dimë mirë:
nuk kemi taksa, errësirë
dhe as malarje e analfabetë,
as ngritje çmimesh...
Jemi fort të qetë:
nuk kemi narkotikë dhe gangsterë
dhe kjo mungesë do të ndihet kurdoherë...

Vazhdimi i përgjigjes mjaft i lehtë:
nuk kemi as diplomaci të fshehtë,
na falni pér këtë mungesë,
në dëshpërimin tuaj s'marrim pjesë,
kështu do të vazhdojmë tërë jetën
ta themi hapur të vërtetën...

Mjerisht, nuk do t'jua bëjmë qejfin kurrë,
t'i mbani me shëndet ata dyzet flamurë,
s'i njohim ne hipokrizitë,
nuk do t'i shkojmë kurrë hasmit pér vizitë...

Dhe mbani mend diçka me shumë vlerë:
pér ne e zeza s'është e kuqe asnjëherë!

RRETH «IZOLIMIT»

Lotë krokodili dërdhka
Moska edhe Uashingtoni,
singjerisht u digjet shpretka:
— Oh, ju mos u izoloni!

«Izolim!», sepse përherë
Shqipëria korr fitore,
di të mbrohet kurdoherë
nga komplotet djallëzore...

Izolim kundrejt çdo helmi
që po bredh lirisht në botë
e tradhtive u vë shqelmin,
që armiqtë të derdhin lotë!

RRITUR NDËR RREBESHE

Rritur ndër rrebeshe
Shqipëri kreshnike,
për disa ti ishe
«shprehje gjeografike».

Se ç't'i shqyen hartat,
ujqit e çakejtë,
kur t'i ndanin fushat,
malet dhe lumenjtë...

Maska diplomatë,
plane kuptimplotë,
lidhën dhe traktate,
bënë dhe komplete.

Helmi i ligësisë
sipër me ca mjaltë,
edhe historisë
i hidhnin pak baltë,

por për ty mendonin
çdo ditë, çdo muaj,
kur me vrap postonin
ndonjë princ të huaj...

Kur sulmuan «miqtë»,
ua tregove vendin,
qysh me pendëzinjtë
ti e ndez kuvendin:

S'e harron asnjeri
shqipen si i shporri,
banjën që u bëri
në mes të qershoret...

Në të zezë ngjyer,
me sëpatë liktori
e me kryq të thyer,
lumi prap' i mori...

Kush ty të cenoi,
s'e pati të gjatë,
dallga i mbuloi
mbretër dhe xhelatë...

Ti e qetë në shqotë,
ballin lart mes vitesh,
hapin tënd një botë
e shikon tek ngjitesh!

VAJTIM NË LARGËSI

Shqipëri, ti qenke
tokë e ashpër shumë,
malli seç na zënka,
shpesh na del në gjumë...

Kurrë s'na besovë,
«kemi këmbë të mbarë»;
ti nuk na lejove
që të hyjmë as zvarrë...

C'fat katrân me bojë,
larg na mban, të shkretën,
dhe me gisht në gojë
na le tërë jetën.

...Plumbat Shqipërie...
Ujë na bëhet gjaku,
dhe sot sikur shtie.
Mujo Ulqinaku!

I kujtojmë plumbat,
«pritje» për Viktorin,
që, për pak, e lanë
kruspull pérandorin...

Ne nuk i harrojmë
sulmet dhe armatën
që nëntorin sollën
dhe për ne... mandatën!

Gur pa lojtur s'lamë,
patëm shumë shpresa,
se ti kishe plagë,
kishe mjaft mungesa...

Ah, proletariati,
diktaturë vuri,
ndryshe ishim gati
të lëvonte druri...

S'futëm, këmbë brenda,
nuk na eci fati:
Mukja dhe Saranda
e më pas Berati...

Shpresa ende patëm,
por ç'e do, votimet...
Prapë u rrropatëm:
erdhën shtetëzimet.

Dëm sërish na vanë
shpresat për rrëzimin,
humbëm krejt davanë:
hoqe shfrytëzimin...

Për ty s'u kursyen
tërë agjenturat,
por ti s'na kuptove,
na përzure burrat...

E na sjell vërdallë
festen e fiqirin,
se e zë të gjallë
kë të shkel kufirin...

«Ndihma» ne si lumë,
se jemi bujarë,
japim rubla shumë,
jo më pak dollarë.

Por ti, kokëshkreta,
nuk pranon huara,
me forcat e veta
dom të shkosh përpara...

Qejfin ne të ngratëve
s'na e bëre kurrë,
ah, kjo pritje e gjatë
qenka një torturë...

Ti nuk paske frikë
e s'pyet për pakte,
paske një logjikë
që mbërthen me fakte.

Pritëm kot, me shpresë
të na shkonte mbarë,
por asnjë harresë
dhe asnjë e çarë...

Ah, mjerisht, në mote
fati nuk na ndriti,
kjo kështjella jote
qenka prej graniti!

Dhe na nxjerr avaze
që duken furtunë,
se ke prova taze
që na prishin punë...

Si shkëmb Shqipërie
qenke kokëfortë,
djeg edhe në hije
dhe na mbyll çdo portë...

Shkuan mbushur rreshje
vité mbi dyzetë,
pa një buzëqeshje,
mbetur si të shkretë...

Nuk na kap gjë çarku
as me grusht e puçe,
ne na digjet barku,
ti qëndron e kuqe!

KUJDES MBRETËROR...

Mesatarja e jetës në vendin tonë u
ngrit në 70 vjet. Para Çlirimt ishte
vetëm 38 vjet.

Kam mbushur sot 38 vjet,
dëgjoj urime shpesh: «Jetë të gjatë!»,
jam mirë me humor e me shëndet
dhe vdekjen s'e mendoj as në mesnatë...

Por ndërsa rri i lumtur, në harë,
padashur, m'u kujtua kohë e shkuar...
Dikur kjo mosha ime e re
s'ishte një mesatare e gjëzuar...

Mesatarisht atëherë, si njeri
duhej t'i thoshe jetës lamtumirë...
Por sot ndiej se jam ende fort i ri,
se kam përpara moshën më të mirë...

Njeriu duhej që të plakej shpejt,
se ishte fort i rreptë ligji i shtetit:
vetëm 38 vjet dhe drejt
në varr: dhurata e Legalitetit...

Nuk ke ç'i bën kujdesit plot farmak,
për mirësi ata ishin të thekur:
që njerëzit të vuanin më pak,
u zgjidhnin hallet vetëm duke i vdekur...

PËRGJIGJJA E ISH-ÇIRAKUT

Një bej, dikur i majmë, fuqiplot,
kur e kuptoi se ditë më të mira
nuk do t'i vinin më as sot, as mot,
na doli që të shesë vogëlsira.

Një bejlereshë, sorrë në pranverë,
po nga ky soj, bulmet nga ai stan,
në tezgë erdh' te miku për të blerë
dy lugë bojë leshi për fustan...

— Nuk zuri, doli boja, efendi, —
u kthye plaka duke iu rrudhur goja.
Një ish-çirak që u ndodh, i tha: — E di,
krejt sojit tuaj i ka dalë boja...

QANI, O MERHUMË...

Shakull Esad pashë,
qani, o merhumë,
se vriste të trasha
për vatanin shumë...

Shiti këtë tokë,
plumb shpërbëlim i dhanë,
për ju linte kokën,
qani, o tiranë!

Vajmedet, c'ju gjeti;
biri i tradhëtisë
porsi qeni mibeti,
ngordhi larg shtëpisë!

Lotët derdhni lumë
më javë, me muaj...
Kur ta qami shumë,
qani veten tuaj...

LUTJA E BALLISTEVE

Dy ballistë plasën pula duke ngrënë,
lajmi porsi bombë kokës u ka rënë.

Të hutuar mbetën, shtang, me gojën plot,
miqtë e Musolinit s'i shpëtojnë dot.

Por nazistët, ndoshta, më të fortë janë:
— Po na dridhen këmbët, ejani, gjermanë!

Ne me plot merita, jemi burra shteti,
do një shtab dhe Balli, dhe Legaliteti.

Mbrona, o Gestapo, fundi u afrua,
na streho ca shtabin në zyrat e tua...

Z A N A T I . . .

— Me kontrabandë merret «madhëria»,¹
s'u ngop sa ishte mbret në Shqipëri,
blen e shet armë t'i shtohet pasuria,
zanatin e ushtroka përsëri...

— Mos u habit aspak se, pa dyshim,
kur mbreti rri si mumje, ndien torturë...
Matrapazllëqe bën dhe në mërgim,
zanati i vjetër nuk harrohet kurrë...

Dikur ka shitur tërë Shqipërinë,
dhe u nxitura për pazarin shpejt...
Pastaj syrgjyn sërisht vazhdoi tregtinë,
të mundte, shiste dhe planetin krejt!

1) Zogolli qëndroi në pallatin e mbretit Faruk deri
në vitin 1952, kur u dëbua edhe Faruku nga Egjipti.

DHURATA E PAPËS...

Kambana e kishës së Komanit, pranë vendit ku ngrihet sot hidrocentrali, ishte dërguar si dhuratë nga papa.

Arriti kambana në kishë,
nga papa u erdhi dhuratë.
Kasollet tymosnin me pishë
dhe Komani hante uratë...

Uri dhe kudo errësirë
n'acar dhe në piskun e vapës,
malësorët i zgjonte pa gdhirë
dhurata e shenjtë e papës!

Legjenda e misrit në lugje
po bridhët me jetën e mjerë,
kambana i ftonte me lutje
dhe frikë të rronin përherë...

Nga dora e papës kushtimi
skalitur më frymë qellore,
në vatra uria, mjesimi
nën tinguj gjëmimesh hyjnore...

Një papë për ta kish menduar,
(kujdesej për shpirrat, bujari,)
i ndiqte din-don pa pushuar
prej djepit dhe gjë përtej varrit...


Por heshti kambana një ditë,
me baltë u mbulua dhurata.
Dhe Drini i lirë jep dritë,
si ditë na duket dhe nata!

II. Masa e beratit

Si është më i vjetër që
dhe i vjetër që është

...tashmë nuk ka vërtet U
...odhat qot te bëjme ose
...vendim që t'ju marrin
...mësimet qëdoq, është më

...Hypërrësa i treg bëj me vërtetë
...nuk është vërtetë që
...nuk është vërtetë që
...nuk është vërtetë që



II. Masa operative

KONTROLLI I ÇANTËS...

U kthye shoku revizor
me çantë si top futbolli,
mbaroi vëzhgimin parimor,
një javë plot kontrolli...

Qëndroi një çast i bërë qull
të pinte ujë në krua,
por një zagar u duk me vrull,
te çanta u lëshua...



E bëri çantën për ibret,
e shqeu, i tërbuar,
me dhëmbë nxori një gjeldet
të rrjepur, të pastruar...

U bë si dyllë në fytyrë,
por gjaku shpejt i shkru
dhe tha me vete: «Hej, shyqyr,
rakinë nuk ma piu!»

POROSI EPRORE...

— Kam télashe dhe po ngutem
veç të them: kjo púnë do bërë...

— Më trëgo dhe qysh, të lutem,
ta kuptojmë gjatë e gjerë...

— Shumë po kërkon nga unë,
ndonëse jam shef vërtet...
(Po ta dija këtë punë,
do ta përfundoja vetë...)

«MË» DHE «NA»... KOMUNISTIKA

Një vit më parë:

- Urime, mora vesh se ju shkon mbarë!
- Ndërmarrja janë doli e dalluar,
më kanë lavdëruar...

Bisedën këto ditë prapë e hapa:

- C'dëgjova? Keni mbetur shumë prapa!
- Po, pëshpëritjet janë të vërteta,
na kritikuani për disa të meta...

- Po më pëlqen metoda ideale,
qenka me shumë vlerë,
se lavdërimet janë personale,
kritikat kolektive kurdoherë...



NJË KOLEKSION I PADËSHIRUAR...

Dikush mban koleksion pikturash,
një tjetër pullash, llullash e gravurash.
Ka koleksione me revista dhe gazeta,
disa koleksionojnë edhe paketa...

Dhe lista mjaft e gjatë mund të jetë,
se shumë koleksione ka në jetë...

Ja, një ndërmarrje del me pretendime
se ka një koleksion me plot vendime...
Sa dalin, i zë gjumi ndër sirtare,
se janë marrë pa u peshuar fare...

F O R M A L I S T I

Nisi shiu pa pushuar,
bie shi sa pér një vit,
por ai, hiç pa pushuar,
tetë hektarë po vadit...

Bie shi, po s'tundet miku.
— Ej, c'po bën, nuk e kuptoj...
— Ke tē drejtë, por grafikun
gjer në fund e respektoj...

DISKUTIME PËR KURSIME...

Mbledhja zgjati,
zgjati,
zgjati,
dymbëdhjetë shkoi sahati...

Dhe kur erdhën nga mëngjesi
thirrën:
— Dritat kush i ndezi?

... Mjaft krenarë për kursimet
digjnin llampat dhe... zotimet!

... T E O R I K I S H T

I qëndron besnik parimit:

«Nga gabimi nxjerr mësim».

Të mësojë prej gabimit

bën përpjekje, pa dyshim...

Mban në xhep autokritikën,

por gjithmonë qëndron në bisht:

«Thellësish e ndiej kritikën,

reflektoj teorikisht!»

Kur gabon nxjerr përfundimin

mos gabojë si këtë herë...

Gjersa nuk i sjell pësimin,

edo gabim paska një vlerë...

ME FAL, TË LUTEM...

Kur ta prura shpikjen; pe se ishte e mirë,
katër vite punë unë për të kam shkrirë,
por ti ngrite supet porsi babaxhani,
më the:

— Shpikjen tënde s'e përmbaka plani!

Të më falësh shumë, sa gabim ndaj teje,
qysh paskam guxuar që të shpik pa leje...
Kam harxhuar kohë, bëj autokritikë,
se ty nuk të pyeta që t'i vije pikë...

E kam shkelur fare dhe të kërkoj ndjesë,
duhej të vendosjeti për ndonjë shtesë,
ndoshta ke të drejtë; s'ka kuptim kjo punë,
një mendim prej teje të mos lypja unë?!

Ndoshta me vonesë sot si asnjëherë
e kuptoj se shpikja ime s'paska vlerë,
ja, padashur unë rezultoj fajtor
si s'të paskam bërë... bashkëautor?!



CILËSI

Ja, mbaroi dhe suvatimi,
s'pritet vëçse përurimi,
por, çudi, si bre, lum daja,
kishte mbetur jashtë kaldaja?

Për ta futur s'lodhesh fare,
veç të prishësh dy dritare,
hap ca vrima nëpër mure
dhe kaldajën shpejt e vure...

Hapen zgavrat për kaldajë
si një gojë që do hajë,
përmbi planin mijëra lekë,
nëse xhepi s'do t'u djegë...

NJË PLAN VEPREMTARISH

Dyzet pikë plani i zbukuruar,
viza,
korniza,
lulka i rrrethuar...

Dhe vetëm katër janë realizuar:
një ekspozitë (e viti të kaluar),
një recension (pjesëmarrës gjashtë vetë)
një ekskursion (dy çape, mjaft i qetë...)
dhe një bisedë fort origjinale:
«Si ta luftojmë punën formale!»

MASA OPERATIVE...

E kuptoi drejt kritikën,
e ndihmoi në vend, pa masë,
mbi zotimin vuri pikën
së ashtu më s'do të ngjasë...

Ja, sivjet nisi më mbarë,
pra, ju lutem, mos e shani,
masa plot na paska marrë,
se i hoqi krejt nga plani...

Le të ngrihet kush të dojë,
se tani nuk ke ç'i thua,
cili mund ta kritikojë
plani pse s'u realizua?

EUFORIKU

Me fjalë ai kodrën e bën mal,
sikur ka hipur në një piedestal:

— Suksesi ynë këdo bind,
jemi më mirë se vjet,
nga gjashtëdhjetë për qind
ne shkuam shtatëdhjetë...

III. Tipa dhe karaktere

NJË VARTËS I GUXIMSHËM...

Po pret me padurim
ta heqin shefin Përparim...
Oh, veç ta heqin, pastaj e di vëtë
qysh do t'i numërojë çdo të metë...

Por shefi Përparim, kryepërpjetë,
çuditërisht, qëndron i qetë...
«Trimi» po hesht, mbledh fakte përsëri
dhe shefit i buzëqesh me dashuri:

«Po mbeti, duhet ison prapë t'i mbaj,
po ra nga fiku, e dërrmoj pastaj!»

S H P È R B L I M

Nuk po them diçka të re
se pas punës ka shpërblime,
por, ju lutem, vini re,
ka çdo rregull përjashtime...

Prandaj një zyrtar kaposh
kurrë s'e harron parimin:
po guxove ta qortosh,
shumë shpejt ta jep shpërblimin...

DO TË PIQET KUR TË RRITET...

Djali s'lë dy gurë bashkë,
babi thotë: «Shkuan vitet!» —
mami thotë: «Prit dhe pak,
do të piqet kur të rritet!»

Djali mbushi dymbëdhjetë,
por familja nuk mërzitet,
ai lagjen s'lë të qetë...
— Do të piqet kur të rritet!



Mbushi sot plot njëzet vjet,
rritet djali, shkojnë vitet...
E njeh mirë një qytet:

— Do të piqet kur të rritet!

Dhe ashtu kaluan vitet
plot me shpresë, dhembshurie:
— Do të piqet kur të rritet!

... Por, ç'e do, u poq në hije!

FILOZOFIA E SERVILIT...

Të jesh servil, nuk bën ndonjë mëkat,
në radhë të parë, nuk je arrogant...
Eprorin e ndihmoj me çdo mënyrë
t'ia lehtësoj ca lodhjen, në detyrë...

Fjala «servil» rrjedh nga një fjalë e vjetër,
të jesh sot shërbëtor ka kuptim tjetër.
Shërbej me zell edhe pishman nuk mbetem,
sepse do vjel ca fryte dhe për veten...



ME KËTO FJALE QË PO FLET...

— Më kritikon? Guxim ke marrë,
a je sylesh apo i marrë?
Kur gojën hap, më hapica punë;
harroke kush ëjam unë?!
Një personalitet i rrallë
që, po të dua, ty të sjell vërdallë,
një personalitet i fortë
që të përplas sot në turinj çdo portë,
një personalitet i shquar
që ta bën gjëmën pa kuptuar...

— Po, e di mirë çfarë je,
e thashë fjalën time dje,
edhe më fjalët që sot flet
ti je një perso — nulitet...



F J A L Ë S H U M I...

— Ju heshtni kur flas unë... Përse vallë s'e hapni gojën, s'bëheni të gjallë?

— Sepse një fill po kape ti, bre burrë, e tjerr edhe nuk di të heshtësh kurrë...

DJALI I MAMASE

Sipér tavolinës
gjalpi, kaçkavalli,
mjalti, uji i Glinës;
është lodhur djali.
Djali lodhet shumë,
fjalë të vërteta,
lodhet se bën gjumë,
pi mbi dy paketa...

Të vështron në heshtje
nëna mallëngjyer,
ulur pranë teje
bukën duke ngjyer.
Ty s'të nxë xhaketa,
as porta e ikalasë,
por për të ke mbetur
djali i mamasë...

Punën e fillove
te portë e shtëpisë,
shpejt ti e harrove
vrullin e rinisë.
Shokët në kantiere
derdhin djersë pa masë,
nuk zbrazin tenxhere
si ti pranë mamasë...

«TE MË SHIKONI NË LUFTE»

Del në qitje shpesh i fundit,
merr nishan, por, zakonisht,
tej tabelës i shkon plumbi,
vret laraska gabimisht.

Kur i thua: «S'je në rregull,»

«Po, — tē thotē, — ke tē drejtē,
vec tē mē shikosh nē luftē,
do shfaros armiqtē krejt!»

Ti i thua! «Ja armiku! Mbrohu shpejt'se të qëllon!»
«Je në vete, — ta pret miku, —
ai është shoku Gjon!»

KUR DEL PIJA.. MONGIR? DA HTI

Simpatik pa masë dukej ai djalë,
shakaxhi, i ciltër, plot lezet çdo fjalë.
Shokët i qeraste, vazhdimisht, në punë,
gjente plot sebepe: — Po paguaj unë,
se jam i gëzuar, njoha sot një çupë,
ndaj jam kaq i lumtur, haj të pimë një kupë...

Po një ditë tjetër pse gëzohej, vallë?
— Oh, sot jam liruar, nxora një dhëmballë...
Dhe qerasja njihte vetëm të përpjetën;
e uronin shokun, e gëzonin jetën...
Lekët i buronin porsi ujë malit,
por qeflinjtë s'pyesnin ku i gjente djali...

Një mëngjes kuptuan tërë marifetin:
miku ag «shpirtmirë» paskësh vjedhur shtetin...
— Si nuk e nuhatëm hajnin e mallkuar?
Le po paskësh vite, vidhët me dy duar...

Qyl kur paske pirë, syri nuk sheh mirë
e, kur të del pija, kthesa vjen vështirë...

ATA DHE TINI NUGJAMI

Po raporton çdo kolektiv fitore
dhe ti, qëndukesh goxha bùrrë,
merresh me tèa rapporte, injekësore
përnijë sëmundje që stë pâte kurrë...

...vendosja e tij, që dëgjohet
...vendosja e tij, që dëgjohet

...vendosja e tij, që dëgjohet
...vendosja e tij, që dëgjohet
...vendosja e tij, që dëgjohet
...vendosja e tij, që dëgjohet
...vendosja e tij, që dëgjohet
...vendosja e tij, që dëgjohet
...vendosja e tij, që dëgjohet
...vendosja e tij, që dëgjohet

RAPORT PËR DASMË

- Qenke i mërzitur...
- Po, besa; jam shumët...
- Dukesh i skapitur...
- S'kam öreks, bas gjumë...
Dhe te mjeku shkova,
por raport s'peshkova...

- Shyqyr, qenke mirë,
ku ka si shëndeti?
- Kot paskam dërsirë,
vajmedet, c'më gjeti.
Ja, prandaj jam tretur
dhe më kap mërzia:
pa raport kam mbetur
dhe... më pret gostia!

NË KRYE TË DETYRËS

Në zyrë hyn çdo ditë fiks më shtatë
se është i përpiktë kurdoherë.
Bisedën rrëth orarit mund ta zgjatë
një orë plot, se koha ka aq vlerë...

Në orën tjetër nis ai debatin;
bën për çdo gol së pakud dy komente,
s'ka faj, nuk mund të ecë kampionati
pa shfaqur ca mendime kompetente...

Aty nga nënta, ndoshta gjer më dhjetë,
tjerr llafe për divorce dhe martesa,
pastaj një orë tjetër ha i qetë,
se merr fuqi të bëjë një dy shkresa...

Më njëmbëdhjetë zërin ngre: «Dëgjoni?»,
me rrethet flet, meraku keq e treti:
zgjidh halle personale telefonit
dhe nuk prish punë se paguan shteti...

Tani të shkelë në terren i mbetet,
e ka në gjak operativitetin:
gjen ndonjë mik të ngeshëm porsi veten
dhe mezes seç ia ndiejnë tok lezetin...

Kur ora dy afron, vjen i kapitur,
i lodhur kokën ul, dremit qyqari,
kur ja, një dorë e fortë e shkund papritur:
— Ngrehu, se mjaft punove jashtë orarit!

«ТИФОЗИ» — ВІДУВІДОВЛЕНІ КІНІКИ

Ja, skuadra iku tutje dhe ti nga pas e ndjek, në xhep shkon me raportin që ta dhuron një
injek...

«Sémuresh» para ndéshjësi nuk je pa disiplinë, se nuk mungon pa leje, adresën mirë ta dëni...

Tifoz fort i sëmurë me ethe rri, rënkon,
nga shkallët e stadiumit shpesh llogari kërkon.

Po humbi skuadra e žemrës, ti' gjuhën s'e përmban,
nuk lë njeri pa sharë, po veten pse s'e shan?

John G. Clegg, Jr., M.D., F.A.P.H.
Editor-in-Chief, *The Journal*
and President, American Society of Allergy
and Clinical Immunology

Когда же виноваты в этом не сами, а кто-то другой, то виноваты те, кто не хотят отдать им то, что им принадлежит.

PYETJE NJË TË PAAFTI

- Ka të paaftë në ndërmarrjen tuaj?
- Asnjë, për besë, ecim bash me shkencë, bëjmë përpjekje për çdo muaj dhe unë mund t'ju flas me kompentencë...
- Ti ku punon?
- Për mrekulli!
- Në cilin seksion?
- Në llogari...
- Sa shkollë ke?
- Kam që dhe... do ta tund!
- Me fakultet a vetëm me maturë?
- Tetëvjeçares dje i dhashë fund, përpiqem për kulturë...



IV. Dhjetë dhe katër

NJË DASMË E PAHARRUAR...

Burrë e grua pranë bisedoijnë shtruar,
do të bëjnë dasmë si s'është dëgjuar,
se martojnë djalin, oh, djalin e parë,
të ndizet ahengu si nuk është parë...
Dhe pa humbur kohë, se askujt s'i pritet,
po hartojnë listat se kush do thërritet...



Soj e sorollopi, miq, komshinj tē tērē,
afro treqind veta gjer tan i janë bérë,
por nuk u mbyll lista, vënë sa më shumë,
lagjja le tē rrije plot një jayë pa gjumë...
Ja, pér shembull, shtojnë edhe xha Trifonin,
meqë në një ditë e marrin pensionin,
thërrasin dhe Maqon, tē nderohet shoku,
kanë udhëtuar vjet në tren së toku...

Oh, sa qenkan mbledhur, dyndet korrideri,
presin dhe në shkallë, edhe tek oborri.
Erdhën me dhurata, hyjnë plot me bujë,
por kë tē sajdisësh në aheng-rremujë?
Po kërcet daullja, ngjiret klarineta,
dhe shtrengohen miqtë rrëth katërqind veta...
Ca mbetën në këmbë dhe po ikin fare,
vend nuk ka tē ulen, veçse në dritare.
Zien fizarmonika, qan me lot violinë,
po ku tē kërcejnë? Veç mbi tavolina!

Mezet seç u ftohën dhe u derdh rakia,
mbetën pa shijuar... dasmën njerëzia,
se mungon përvoja, është dasmë e parë;
pér dhuratat lypset një aneks t'i marrë...

DHJETË DHE' KATER

— C'po'ndodh kështu, t'or tungjatjeta?
Këtu, patjetër, paska ngatërresa:
maturën e mori me dhjeta,
në fakultet me katër dhe me pesa?

— Me sa marr vesh dhe, me sa thonë,
ndër qarqet familjare,
miqtë e babait prej qytetit tone
në universitet mungojnë fare...


— Në fakultet që ka qenë, që ka qenë,
në universitet që ka qenë, që ka qenë,
në universitet që ka qenë, që ka qenë,
në universitet që ka qenë, që ka qenë,

— Në fakultet që ka qenë, që ka qenë,
në universitet që ka qenë, që ka qenë,
në universitet që ka qenë, që ka qenë,
në universitet që ka qenë, që ka qenë,

KUR NJOHJA ËSHTË «RRUFE» ..

Treni u nis nga Gur i Kuq,
përtej lundrojnë retë, —
ata të dy vështronën shpesh,
biseda rrjedh e qete...
Ajo leshverdhë, ai zeshkën,
ajo me sy si deti,
ai me trupin si asllan
dhe ndizet muhabeti...

Liqeni djathtas, majtas mal,
mes tyre rruga zgjatet
si kjo bisedë që nuk ndal
se zemra hap kanatet...



Tuneli i gjatë i bashkon
në gjysmërrësirë,
asgjë në Prrenjas nuk i ndan,
u bënë miq të mirë...

Në Qukës nuk shkëputen dot,
ky tren i ka bashkuar,
pastaj Librazhdë dhe më ngrohtë
i pret si të fejuar...
Në Elbasan më fort shpërthen
kjo dashuri pa hile,
do të martoheshin në tren,
të kish gjendje civile...

Por ja ky udhëtim vazhdon:
afrohet Rrogozhina
dhe djali vajzës i kupton
ca cene, mbeturina...
Ajo i hodhi një vështrim
një flokëkaçurreli:
— Këtu nuk bëj asnje lëshim!
Besnikerinë shkeli...

Nuk flasin fare, sa mërzi,
ç'hëndek midis, papritur...
Ajo e heshtur dhe ai
me sy të çakërritur...
Kavaja mbetet pas, tani
vjen Durrësi dhë deti.
U zbeh në çast kjo dashuri,
u pre dhë muhabeti...

Ja, në Tiranë treni hyn
dhe ndarja është e plotë.
Përrallë është tregimi ynë,
veç të vërtetën thotë...



Ja, në abe të tashme kemi qenë
dhe përfundimisht nuk vemi që
nuk i dëgjohem se çfarë është
një trezë që nuk mund t'i marrim.

Ja, në abe të tashme kemi qenë
dhe përfundimisht nuk vemi që
nuk i dëgjohem se çfarë është
një trezë që nuk mund t'i marrim.

NENET E RREGULLORES SHTËPIAKE

Kur në skenë dilte dhe këndonte shtruar,
sallën ngrinte peshë vajza e talentuar,
sot bilibili, vallë, pse s'dëgjohet fare,
pse rrri e menduar vajza në dritarë?

Mos u tret papritur zjarri i rinisë?
Qenka bërë nuse, tjeter këngë do nisë...
I mësoi dhe fjalët edhe melodinë,
tani bëka prova brenda në kuzhinë...

U martua vajza? Meloditë u prenë,
sïka lezet të ngjitet përsëri në skenë,
se shtëpi e burrit nxjerr një rregullore,
që nuk mund të lihet kurrsesi pas dore...

Ndaj u shuan tingujt, ndaj u pre dhe gazi,
mjaft këndoi një herë, sot ndryshoi avazi:
të mos kapërcejë pragun e shtëpisë,
le t'i ndjekë vjehrra mbledhjet e rinisë...


Të mos grinden kurrë dhe rehat të jenë,
burri të këndojet n'vend të saj'në skenë...

URIME —

URIME ...

— E martove vajzën, të-të trëshëgohet, edhe shoqeria s'mund të mës gjëzohet, se je shpirt njeriu, përkëdøje shikrirë, lum si ne, të kemi mikun më të mirë...

Ndaj u dynd dynjaja, pate mjaft vizita, natyrisht, i fundit radhën nuk e prita, ta prura sahatin larë ujë floriri, se nga tërë miqtë ti je më i miri...



Si mund të mos isha mirënjohës unë?
Ti më freskon ballin, më mbaron çdo punë...
Ke për ta festuar pesëdhjetëvjetorin,
meriton me ngjyra ti televizorin...

Ne të duam shumë dhe e di një botë,
dëgjo zemrën tonë, xheç do të të thotë:
«Ki kujdes, të keqen, mos është tret zotimin,
djali ynë me shtata do të drejtë studimi...»

NUK JE SUPERSTICIOZ...

E di, nuk je supersticioz,
s'të bën përshtypje asgjë, për besë,
por si një tip tepër studioz
lexon edhe filxhanin e kafesë...

the main body of the town, and
the principal street, which is about
one hundred and fifty feet wide,
and contains a number of large
houses.

Georgian language, and the first book printed in Georgia, was published in Tiflis in 1801.

NDĒRHÝRJE ORIGJINALE

Kur po afroheshin provimet,
vërshorin imiq pashëtë e përpjete
dhe shtoheshin përhëre pretehdimet,
secili, më çdo kusht, kërkonte dhjetë...

Ndërhyrjet s'kishin të mbaruar,
në mes të vapës më kishin mërzitur,
por njérën s'kam për ta harruar,
në tru më mbeti e skalitur:

— Ka mundësi që të më bësh një nder?
Filanin të ma lësh në klasë,
rrëzoje edhe po diti, se bëmë sherr...
Ty mirënjoës do të t'jem pa masë!

NUK E PASHË NUSEN

— Që kur u martuat
gjashtë muaj shkuan...
Ku i patë sytë?
Pse e ndave gruan?

— Ti më shan, si duket,
s'di ku që belaja:
nuk e pashë nusen,
e mbulonte paja!

— Tu keni qëndruar
dhe nuk e pashë nusen,
nuk e pashë nusen,
nuk e pashë nusen.

FRÝMEZIMI I NJË TË «PAEMRI»

Talenti fluturon; nuk e mban dot,
si zog shpértheka tutje në hapësirë.
Ai një çast nuk mund të rrijë kot,
pa vrarë mendjen, letra varg pa nxirë...

Po shkruan, shuan, shkruan me pasion,
duke i ndezur tërë bateritë.
I zhytur në ekstazë, endërron
se ç'bujë mund të bëje ai një ditë...

Po cfarë thurka? Drama, poezi
me tema kardinale a intime?
Oh, jo, i kredhur, zverdhur në vetmi,
po shkruan vetëm... letra anonime..,

KUR FLET ZEMRA...

Suksesi i kolegut në fillim
e turbulloj, por duhej ta uronte,
ndaj i dha vetes pak guxim
që duke buzëqeshur, ta duronte.

Veçse tek bluante imtësisht
mendimin për kolegun plot nderime,
kur e takoi, i foli gabimisht:
— T'uroj, nga zemra... ngushëllime!

PAS DIPLOMËS

Shkollën e mbarova,
dola sot në jetë,
mjaft u torturova
libra,ditë e netë...

S'kam aspak nevojë
t'ju shfletoj, oh, kurrej,
se lexoj diplomën
dhe fitoj kulturë...

NOTË PËR CA' NOTA NË MUSIKË

— Të mahniti kënga ime?

Shtatë nota, vetëm shtatë,
por sa ndjénja, frymëzime
që shpërthejnë në kantatë...

— Kënga jotë s'është pavarlerë,
titullin të gjithë ta dinë...

E dëgjoja njëqind herë,
por s'e mbaj mend melodinë...

KUR MUNGON NJERIU

— Ah, kjo piktura m'i shteroi fuqitë,
më lodhi mjaft, për ideal,
i pasqyrova krejt makineritë
me hollësi, në çdo detal.
Mos u nxito, gjyko gjakftohtësisht,
e pjekur le të jetë analiza,
shprehu lirisht e folmë singjerisht.

— Urime, më pëlqeu... korniza!



E P I T A F

«Në këtë varr prehet i qetë
ai që nuk pushoi një jetë:
shkroi me vullnet për çdo drejtor
raporte dhe fjalime,
ka mbetur i kënaqur çdo epror,
se pati për të gjithë frymëzime...»

Na u specializua ai kaq shumë,
sa i shikonte edhe në gjumë
fletët e nxira me durim,
që po vërshonin porsi lumë,
la shkruar dhe për vete një fjalim
me shpresë t'ia lexonin në varrim!»

PËR... KTHIM

— Kam përkthyer dy vëllime,
po habitem edhe vete
lapsi në fletoren time
ecën shpejt si një raketë...

— Vrulli yt nuk ka të sharë,
dorëshkrimet mbaji mirë,
se dikush mund të t'i marrë
tok me çajin për t'i... pirë!

SHALLOV

— Nëpër fildozqen e TCAZ
në këtë gjë vëzqen qum bë
njohje obg rrap tenkut omi jo nda
vulli i vulli e qen
njohje obg rrapshkë i madhësht
dëshillëm që vëzqen e TCAZ

— Njohje obg rrapshkë i madhësht
dëshillëm që vëzqen e TCAZ
njohje obg rrapshkë i madhësht
dëshillëm që vëzqen e TCAZ


RECETË REGJISORIALE

— Për të nxjerrë një premierë,
besa, u lodha pa masë,
çdo aktori këtë herë
i mësova si të flasë...

— Personazhet ishin dhjetë,
por veç një për spektatorin...
Që të dhjetë, me recetë,
imitonin regjisорin...

K O P E R T I N E

— Sivjet, më the, romane ke nja tre...
Asgjë s'kam kundër planit,
vetëm diçka vë re:
çdo vit i ndërrohet titulli romanit...



J A S T Ě K U

Ikin ditë, ikin vite,
po shkon shekulli revan,
ti u lodhe, u kapite
duke shpallur ç'ke në plan...

Dhe shikonëndrra madhore,
por studime s'bën aspak.
Vë jastëk «gradën shkencore»,
për të fjetur pa merak.

V. Binjakët

FTESEË NËN SHI


— Lart në qiell mblidhen retë,
ju mendojmë për çdo ditë,
mos harroni se në jetë
garancia e vërtetë
jemi ne superfuqitë...
Ejani nën çadrën tonë,
jemi miq dhe jemi shokë...

— ...Që të lagemi gjithmónë
këmbë e kokë?

Platitëv e përgjithshëm
Për këtë që është më i madh
KURSHITEN PARIMET

*Revizionistët sovjetikë dhe vasalët
e tyre i kanë shtrirë dorën kapita-
lit të huaj.*

— Bankat tona venë mbarë,
me stërlina dhe dollarë,
me kredi lëviz dhe mali,
në Amerikë shkon Urali,
përtej Rinit Kaukazi,
mbushet qesja, shtohet gazi...



Fryhen xhepat nga fitimet,
se lëvizim shpejt parimet,
që i kemi elastike,
natyrisht, mjaft specifike,
shkathtësi në politikë,
se nuk jemi dogmatikë...

Presim me hare trustmanë
që na sulen nga çdo anë,
kur zbardh dita, kur zurret nata,
me oferta dhe kontrata...
Ne i çmojmë kurdoherë
si një kapital me vlerë...

Jo i Marksit «Kapitali»,
por fitimi...

Ideali
që na frysmezon në jetë
është brenda në... kuletë.
Vec të shkojë pazari mbarë,
pa durojmë çdo të sharë...

Po kërtoi Uashingtoni,
me qira japim ç'të doni,
dhe kodrat e Turkmenisë,
dhe pyjet e Siberisë...
Kush gënjen i rëntë rrufeja:
shesim dhe tokat e reja...

— Ju besojmë pa u betuar,
mos u lodhni me betimet,
ju tregtinë keni filluar
qëkurse shitët parimet!

MINUTA FATKEQE

Presidenti Regan pagoi 75 mijë dollarë, për të ndërprerë 60 sekonda një film televiziv për t'u folur shkuësve gjatë fushatës elektorale.

Ishte një film i tmerrshëm me gangsterë, dikush hidhte një grua në humnerë, ankthi në kulm i ngritur, por pikërisht në këtë çast, papritur, filmi u pre dhe doli në ekran aktori i njojur pehlivan Ronald Regan:

— Të dashur telespektatorë, më falni se kam gjetur këtë orë që t'ju premtoj parajsën e vërtetë, si president të kem edhe ca jetë, ta zhduk papunësinë me inflacionin dhe pabarazinë! Republikan me nam jam, goxha burrë, fjalën e mbaj në gjuhë, nuk e ha kurrë...

O

Për një minutë ç'humbën oratorët? Miliarda do paguajnë spektatorët...

GRUSHTI...

Brohoriste Amerika
dhe e njihte bota mbarë,
ai s'dinte ç'është frika,
grushti i tij grinte dollarë...



Trusti «Bruklin» e kish blerë
(i bleu muskujt me kontratë),
emrin «Bruklin» kurdoherë
ta përhapte ditë e natë...

Fjalën «Bruklin» ta shënonte
mbi këmishë, mbi xhaketë,
mbi kapelë, pantallona
edhe ku e dinte vetë...

Në ekran e faqe shtypi
të bërtiste që pa gdhirë:
«Vetëm «Bruklin» të përtypni,
camçakëzin më të mirë!
Nxjerr nokaut kundërshtarët;
se përtyp, dimër e verë,
vetëm «Bruklin», më shkon mbarë,
camçakëzi më me vlerë!»

Veç një ditë prapa mbeti,
doli, befas, jashtë luftimit,
në spital/erdhi në vete:
ish fillimi i mbarimit...

Grushtin lart dikur e ngrinte,
tok me forcën fama shteri...
Pranë urës «Bruklin» rrinte
dhe po lypët ish-boksieri...
Para tij kaloi i lumtur
një kampion i ri me famë,
që për camçakëzin «Bruklin»
perséri bënte reklamë...
Nuk i hodhi as vështrimin
kundërshtarit të dërrmuar,
por i foli ky i fundit:
— Mos u fry dhe merre shtruar...

Edhe ti do vish më vonë
që të lypësh te kjo urë...
Pas të ndjek grushti i padronit,
s'ke për të shpëtuar kurre!

VITI I RI NË AMERIKE...

Viti i Ri me thesin erdhi në mesnatë,
një gangster, pëpritur, s'e bëri të gjatë,
ia rrëmbeu thesin, iku n'errësirë,
Viti i Ri ia priti: — Ke qëlluar mirë,
se peshqeshin more për krejt Amerikën;
kriza do të dalë kur t'ia zgjedhësh grykën...

...DHE NË BS REVIZIONIST

Rrugëve kalojnë disa huliganë,
dhe po pinë vodkë, marrin marihuanë...
Ca studentë të dehur, në mes profesori,
Viti i Ri vë notën: «Lumi që i mori!»

Duken ca të tjërë, ngajjnë si fetarë,
kryqin nën këmishë, që t'u shkojë mbarë...
Qejf, o qejf që bëjnë, hej medet c'i gjeti
«socializmi» i tyre: Krishti e Muhameti!

PREMTIME / PRESIDENCIALE

Statuja e Lirisë rrj menduar
se tjera vite do të ikin paskëtaj,
por kriza s'ka ndër mend për t'u larguar,
se e ndien yeten në shtëpi të saj...
Kush nuk e do, mund që të flasë
se mbyll fabrika dhe ndërmarrje mbyll,
ajo po konkurron yjet e kinemasë,
më popullore n'Amerikë se çdo yll...

Po shtohen ethet, jepen plot premtimë,
vazhdojnë përgatitjet në qdo front,
dhe duket, me shantazhe e kërcërrime,
një president i ri në horizont.
Si zakonisht, pëllumba mban në duar,
por nën xhaketë bomba ai mban...
S'ka rëndësi se emrin ka ndryshuar
nga Xhimi Karter në Ronald Regan...

S'ka të papunë dhe po ulen qmimet
në ëndërr, ç'mrekulli!
Po nesër, kushedi, mbahen premtimet
dhe, ndoshta, zhduken veg... në teori...
Një vend çudirash Amerika,
këtu çdo ditë thyhet një rekord:
kush natën ha më shumë thika,
më shpesh kush flakët nga uzinat «Ford»...

«...E BUKURA AMERIKË!»¹⁾

Moj Amerikë, «e bukura Amerikë»,
xhandar që përtej detit,
mban mes dafinave një thikë
përzmërsisht t'ia ngulësh krejt planetit...
Daj Samit fort i dhimbset njerëzimi,
ndaj bombat shton të lulëzojë planeti,
të përparojë qytetërimi,
të jenë të qetë toka, qelli, deti...

Moj Amerikë, «e bukura Amerikë»,
modeli i «demokracisë»,
me dy parti dhe dy milionë kamxhikë
bekuar nga Statuja e Lirisë...
Për ty thur aventura Pentagoni,
të duan bosët dhe spiunët,
por ç'tu vardisëni kriza, inflacioni,
ç'faj ke se vrasin veten të papunët?

Moj Amerikë, «e bukura Amerikë»,
e Jugut, e Veriut,
prej teorisë hidhesh në praktikë
e nepërkëmb «Të drejtat e njeriut»...
Rekorde na vendoske me «lirinë»,
të cmojnë Uoll-Striti dhe trustmani,
kush s'ta kupton ty drejtësinë,
sqarohet shpejt nga Ku Klux Klani...

1) Është titulli i një këngë amerikane, që ekzekutohet në Shtëpinë e Bardhë kur priten personalitetë.

Moj Amerikë, «e bukura Amerikë»,
parajsa ideale,
që ëndrrat i servir me narkotikë
dhe barazinë me ligjet raciale...
Ke një Shtëpi të Bardhë si katrani,
një president që nuk premton në erë,
se demokrati dhe republikani
e hanë fjalën që të dy përherë...

Moj Amerikë, «e bukura Amerikë»,
me siguri prej varri,
ku çdo gangster vepron pa frikë,
se rojë bën polici dhe dollari...
Ti emrin lart e ngre në botë
kur i shfaros zezakët pa mëshirë,
tregon, plot njerzillëk, se ç'do të thotë
«botë e lirë»...

Moj Amerikë, «e bukura Amerikë»,
ndërhyr nëse të preket ty kufiri,
përtej në Azi, Evropë dhe Afrikë
dhe rritet vazhdimisht zinxhiri...
Duke menduar botën, s'paske gjumë,
dashke të lumturohet krejt planeti,
ndaj CIA derdh agjentë, pare lumë
që juntat të shpërthejnë grushte shteti...

Moj Amerikë, ku e paske bukurinë?!
Kolombi ty dikur të ka zbuluar,
tanimë ti zbulon çdo ditë shëmtinë;
fytyrën tënde të «qytetëruar»...

KLIMË DËSHTIMESH

Dëbora e mbuloi Rusinë,
por s'i mbulon dështimet në çdo plan,
si ngushëllim një car e ngre dollinë
për një sukses-rrufe n'Afganistan...

Luftën rrufe e ëndërrroi Hitleri,
dhe me tërbim sulmoi, por më kot,
me stilin që i la trofe i ndjeri
shpreson një Car që fat të ketë sot...



Kabuli le të mbetet si i shkretë,
të marrë masa një Babrak Karmal,
dhe ambasada ruse le të jetë
si një fortifikatë atje në mal...

Ekspertët èndërrojnë plot fitore,
të tjerë trima do të vijnë përsëri
se u pëlqeka fort klima malore,
por dhe një qese najlon me hi...

SHVEJKU «FESTON»... PËRVJETORIN

„e agresionit të Traktatit të
Varshavës kundër Çekoslllovakisë,

Shvejku paska festë:

— Erdhi përvjetori,
erdhën karnavalet
dhe... okupatori!

«Miqtë» që janë shfaqur
sollën plot fitore,
jemi të kënaqur
porsi... në thertore.
Hitlerianët derdhën
gjak e krime shumë,
të «Traktatit» erdhën
e na ranë në gjumë...

Plot sukses marshuan:
jemi krejt të «lirë»,
mbajmë, kur të duam,
pranga dhe zinxhirë...

Jemi të «pavarur»,
jemi të «gëzuar»,
me sovranitetin
pak të kufizuar,

me sovranitetin
copë dhe thërrime,
se ai sot mbeti
vetëm ndër fjalime...

BEKIMET E VATIKANIT

Nëpër shekuj si demoni,
varur kryqin si këmborë,
dha bekim inkuizacioni
për sa mbretër, perandorë.

Stivë-stivë ndezur drutë,
fryu zjarrin e bekuar,
që t'i mbushen botës trutë
se kush digjet, ka gabuar...

Veç Xhordano¹⁾ në torturë
si pishtar u ngrit përjetë,
nuk i ktheu bindjet kurrë,
priti flakët aq i qetë!

...Dhe bekoi Vatikani
Duçen e Hitlerin bashkë,
e pastaj për kasaphanën
derdhi lotë, vuri maskë...

1) shkencëtari Xhordano Bruno.

Bekoi bombëن atomike
té pëlcasë sa më parë,
bekoi armët strategjike
për ca rubla dhe dollarë...
Kriminelët e tradhtarët
i bekon i mallëngjyer,
mik për kokë me barbarët,
kryqi i tij si Kryqi i Thyer...¹⁾

¹⁾ simboli i nazizmit

NJË LIBËR I RRALLE

Në art, nga teoria dhe praktika
çudira shumë paska Amerika...

Një libër plot me dyqind fletë
pa germa krejt, ku çdo njeri
si mund t'i teket vetë
shënon një histori...

Edhe kur je analfabet,
mos e prish gjakun kurrë,
ta mbash librin nën sqetull ka lezet,
se rrugës bën figurë...

U lodhën mjaft për këtë fabrikim,
por rëndësi ka, pa dyshim,
jo realiteti,
vetëm marifeti...

Dyzetë dollarë i ka hak,
me tërë atë kulturë,
se libri paska një kapak
të fortë, flake pa merak,
nuk prishet kurrë...

ZINXHIRI I TRADHTISE

1.

Hrushovin, pa bujë, e hipën në fron
dhe duart ferkoi Perëndimi.
se koka e ndritur tani po sundon,
pas tij butësia, pendimi...

«Shkëlqen madhështor si ylberi në stepë,
gëzohu për birin, o nënë!»
(«Heroi i shkathët që llomka na jep,
dikur majmës derrash ka qenë...»)

...U ngritën kufomat e ndezën qiri
dhe Trocki u ngrit, Buharini.
Tërbimi i bardhë sulmon përsëri,
mëkat se mungon Rasputini...

Vërshuan zagarët pas tyre, në llum,
po zhgërryhej tradhtia me fletë,
se shpifjet u ngritën gjer në presidium,
kur behu Kongresi i Njëzetë...

Një «shok sekretar» më i mirë nuk ka,
ky qenka person ideali.
Fituam ç'ka humbëm, s'i thonë shaka,
plot shpresa buzëqesh kapitali.

Po rritet armata: «Na prij, o Hrushov!»,
të bardhët nuk janë të pakët,
vërsulen nga janë dhe s'janë, me hov
pas tyre po rendin kulakët...

2.

Po skuqet, po zverdhet, përdridhet në fron
se fjalët i duken shigjeta,
në Mbledhjen e Moskës diçka belbëzon,
sa fort e tmerron e vërteta!
Vërshojnë akuzat, a bie tërmët,
stuhia po fryn n'atë sallë?
Nikita, veshulur, me vete po flet
dhe mendja i sillet vërdallë...

Vërsulen vasalët ta mbrojnë... Më kot
përpiken me zellin e frikës,
padroni i tyre nuk mbahet më dot,
tërbohet përpara logjikës.
Ashtu i mbërthyer gozhdohet në vend,
me mjegull në sy e në kokë,
intriga, komplotë të reja ndër mend
dhe maska i bie përtokë...

Parajsën çdo ditë i qeshur premtion,
por lumi premtimet i mori,
se treten si fjalët me okë, me ton,
me poza prestidigjatori...
Plot duartrokitje dhe... flluska në fund,
dështimet vërshojnë si lumë,
se fjalët me veprat nuk puqen kurkund,
sukseset i zë vec në gjumë...

3.

Kuadrot i zgjodhi me shumë kujdes,
mes tyre kolltukët i ndanë,
rrëmbyen pushtetin, e futën në thes
dhe kryqet afroan më pranë.

Beko, perëndi, një epokë që ngjall
ata që Tetori përmbysi,
fundrrina nga varri ngre në piedestal,
e merr kapitali yryshin...

Beko, perëndi, burokratin padron,
beko paqësoret mëngjese,
se nuk do të ketë më revolucion,
por majmje të kastës borgjeze...

Nuk ka rëndësi nëse quhen Hrushov,
në fshehin pas frazash qëllimet,
Brezhnev, Andropov, Cernienkov, Gorbaçov;
të njëjtat po mbeten parimet...

4.

E bindur suita ka mbetur në KNER,
besnikë këndon melodinë...
Një shkop dirigjenti drejton dhe u merr
lëkurën, ta ngopë Rusinë...
Po grinden, shqelmojen dhe grinden ata,
se kjo dashuri i mban pranë,
po ngriti një vetull, shamatë më s'ka
dhe sus e vështrojnë ustani...

Kur, befas, dëgjohet një zë që rënkon;
mjerisht, po cenon harmoninë,
por shpejt ngrihet shkopi, padroni gjëmon
dhe miqtë kujtojnë «dashurinë»...
Aty janë topat dhe tanket e zinj
për «mbrojtje» dhe «ndihmë» bujare...
Kush bluan në mendje diçka kundër tij,
sqarohet mos flasë më fare...

Çdo çar, pas Hrushovit — gjeni e profet,
vetëshpallet sa hipën në fron...
Të gjithë ata kanë veç një të metë:
secili Totorin harron...

andere op en oefend en oefend
en oefend en oefend en oefend en oefend
en oefend en oefend en oefend en oefend en oefend
en oefend en oefend en oefend en oefend en oefend en oefend
en oefend en oefend en oefend en oefend en oefend en oefend
en oefend en oefend en oefend en oefend en oefend en oefend

en oefend en oefend en oefend en oefend en oefend
en oefend en oefend en oefend en oefend en oefend en oefend
en oefend en oefend en oefend en oefend en oefend en oefend
en oefend en oefend en oefend en oefend en oefend en oefend

PËRMBAJTJA

1. Na falni për këto mungesa

Përgjigje e lehtë	3
Rreth «izolimit»	4
Rritur ndër rrebeshe	5
Vajtim në largësi	7
Kujdes mbretëror...	11
Përgjigja e ish-çirakut	12
Qani, o merhumë...	13
Lutja e ballistëve	14
Zanati...	15
Dhurata e papës...	16

2. Masa operative

Kontrolli i çantës..	18
Porosi eprore...	20
«Më» dhe «na»...	21
Një koleksion i padëshiruar...	22
Formalisti	23
Diskutime për kursime...	24
Teorikisht	25
Më fal, të lutem...	26
Cilësi	27
Një plan veprimtarish	28
Masa operative...	29
Euforiku	30

3. Tipa dhe karaktere

Një vartës i guximshëm...	31
Shpërbirim...	32
Do të piqet kur të rritet...	33
Filosofia e servilit...	35

Me këto fjalë që po flet...	36
Fjalëshumi...	37
Djali i mamasë	38
«Te më shikoni në luftë!»	39
Kur del pija...	40
Ata dhe ti...	41
Raport për dasmë	42
Në krye të detyrës	43
«Tifozi»	44
Pyetje një të paafti	45

4. Dhjetë dhe katër

Një dasmë e paharuar	46
Dhjetë dhe katër	48
Kur njohja është «rrufe»...	49
Nenet e rregullores shtëpiake	52
Urime...	53
Nuk je supersticioz...	55
Ndërhyrje origjinale	56
Nuk e pashë nusen...	57
Frymëzimi i një të «paemri»	58
Kur flet zemra...	59
Pas diplomës	60
Notë për ca nota...	61
Kur mungon njeriu	62
Epitaf	63
Për... kthim	64
Recetë regjisoriale	65
Kopertinë	66
Jastëku	67

5. Binjakët

Ftesë nën shi	68
Kur shiten parimet	69
Minuta fatkeqe	71
Grushti...	72
Viti i Ri në Amerikë...	72
... dhe në BS revizionist	74
Premtime presidenciale	74
«.. E bukura Amerikë!»	75
Klimë dështimesh	76
Shvejku «feston»... përvjetorin	78
Bekimet e Vatikanit	80
Një libër i rrallë	81
Zinxhiri i tradhtisë	83
	84

Bubani, D.

Pa doreza... Poezi satirike.

[Red.: F. Malo]. T., «Naim Fra-
Shëri», 1986.

92 f. me il.

(B.m.) dhe

(B.v.) : 891.983-1

+891.983-7

B 88

Tirazhi 2000 kopje Formati 49x78/16 Stash: 2204-82

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re
Tiranë 1986